



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2355/14 Prot.

Durrës, më 27. 11 .2024

V E N D I M

Nr. 77, Datë 27. 11 .2024

PËR

"MIRATIMIN E TARIFËS SË PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, BACHELOR NË "INTERNATIONAL BUSINESS MANAGEMENT", PRANË DEPARTAMENTIT TË MENAXHIMIT, NË FAKULTETIN E BIZNESIT, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS, PROGRAM I PËRBASHKËT STUDIMI ME INSTITUTIN POLITEKNIK TË BRAGANCES, PORTUGALI (INSTITUTO POLITECNICO DE BRAGANCA- IPB)"

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 2, gërma b; neni 35 pika 1; neni 49; VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" i ndryshuar; VKM-në nr.185, datë 25.3.2021, "Për ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; VKM-në nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"; Udhëzimin MASR Nr.1, datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisë kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë", i ndryshuar; në Statutin e UAMD-së; Rregulloren e UAMD-së, vendimit të Senatit Akademik nr. 41, datë 26.11.2024, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I :

1. Miratimin e tarifës së programit të ri të studimit të ciklit të parë, Bachelor në "International Business Management", pranë Departamentit të Menaxhimit, në Fakultetin e Biznesit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, program i përbashkët studimi me Institutin Politeknik të Bragances, Portugali (Instituto Politecnico De Braganca- Ipb).
2. Tarifa për këtë program studimit do të jetë 25.000 lekë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Drejtoria e Administrimit Financiar
 - Drejtuesi i Njesisë Kryesore
 - Drejtoria e Kurrikulës dhe e Standardeve të Cilësisë

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

